



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 59 Prot.

Tiranë, më 02/06/2025

UDHËZIM

Nr. 1, datë 02/06/2025

PËR

**SHPLLJEN E AFATEVE TË KANDIDIMIT, SI DHE DORËZIMIN E
DOKUMENTACIONIT PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE DHE DREJTUES TË
NJËSISË BAZË**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, pika 2, neni 18 dhe 25, si dhe urdhrin nr. 24, datë 28.05.2025 të Rektorit “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

UDHËZON:

1. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (FIM, FIMIF, FIN) të shpallin afatin për fillimin e dorëzimit të dokumentacionit të vetëkandidimit në KIZ.
2. Afati për dorëzimin e dokumentacionit të fillojë në datën 05.06.2025 dhe të përfundojë në datën 09.06.2025, ora 16:00.
3. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete, të shpallin kriteret dhe listën e dokumentacionit për kandidim në përputhje me nenin 25, pika 1 të rregullores.
4. Dokumentacioni i kandidimit për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësisë bazë, do të dorëzohet pranë Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, sipas nenit 25, pika 1 të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024–2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës”.

5. KZF- të do të tërheqin listën e dokumentave të dorëzuar pranë KIZ në datën 09.06.2025, ora 16:30 për të kryer regjistrimin përfundimtar dhe shpalljen e kandidatëve jo më vonë se 24 orë nga dita e marrjes në dorëzim të dokumentacionit.
6. Brenda datës 11.06.2025, KZF të dërgojnë në KIZ një kopje të vendimit për regjistrimin e kandidatëve. Vendimi publikohet nga KZF dhe një kopje e tij i vihet në dispozicion KIZ.
7. Formularët që duhet të plotësohen nga kandidatët për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të Komisioneve të Përhershme për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, janë sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar

Alfred PJETRI

Anëtar

Albina BASHOLLI

Anëtar

Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar

Nelda KOTE

Anëtar

Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar

Klajdi QOSHI

Anëtar

Pietro BELBA

Anëtar

Lidia HYSA

Anëtar

